



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:267647
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05603255

K.Dh.Sh.II.nr.507/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Fam Gas LLC” me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.407/19, të datës 21.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet ankesa e të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, e dt.10.12.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A.nr.470/19 i datës 21.10.2021, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar, ka vendosur Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “Fam Gas LLC” me seli në Fushë Kosovë si e bazuar, Anulohet vendimi nr.552/2018 i datës 08.01.2019 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), që paditësit Fam Gas LLC” me seli në Fushë Kosovë, t’ia pranoj TVSH-në e zbritshme për dokumentet Unike Doganore R-14464/09.09.2013 dhe R-11451/09.09.2013, në shumën prej 45,377.06€, së bashku me interesin e paguar ne shumën prej 12,982.52€ dhe ndëshkimet e paguara në shumë prej 10,846.96€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 69,206.54€ (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtë euro e pesëdhjetë e katër cent), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi.

Kundër këtij vendimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura ATK, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, propozon që të aprovohet ankesa ATK-së si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i atakuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi i Departamentit të Ankesave nr.522/2018 datë 08.01.2019.

Në përgjigjen ne ankesë të datës 13.01.2022, paditësi e kundërshton në tërësi ankesën e të paditurës dhe kërkon nga gjykata që të mos ndryshohet aktgjykimi kontestues.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesat është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me Vendimin, nr.522/18 të datës 08.01.2018, ka refuzuar si të pabazë ankesën në nr.522/18 të datës 09.11.2018 të subjektit “Fam Gas LLC” me numër të biznesit (NRB) 70356526 dhe munër fiskal NRF:600244032 me adresë në rruka e “A.Qesma” – Fushë Kosovë në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit 05/L-031 “Për Procedurën Administrative” në lidhje me nenin 89 paragrafin 2 të Ligjit nr.03/L-222 Për Administratën Tatimore. Procedura e ankesës nuk ndërpre në sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi sipas Ligjit 03/L-222.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, paditësi, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, e anulon vendimin e të paditurës nr.522/18 të datës 08.01.2018 dhe e obligon të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), që paditësit “Fam Gas LLC” me seli në Fushë Kosovë, t’ia pranoj TVSH-në e zbritshme për dokumentet Unike Doganore R-14464/09.09.2013 dhe R-11451/09.09.2013, në shumën prej 45,377.06€, së bashku me interesin e paguar në shumën prej 12,982.52€ dhe ndëshkimet e paguara në shumë prej 10,846.96€, të gjitha këto në vlerë të përgjithshme prej 69,206.54€ (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtë euro e pesëdhjetë e katër cent), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi. Në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar është konstatuar se Gjykata me deklaratat doganore IM7, në kuadër të depos doganore, e që janë administruar si provë në këtë lëndë të konfliktit administrativ, dhe atë DUD-at IM7 13621/26.08.13, 13562/26.08.13, 13563/26.08.13, 13561/26.08.13, 13338/21.08.13, 13620/26.08.13, 13618/26.08.13, 13616/26.08.13, 13614/26.08.13, 13615/26.08.13, 13613/26.08.13 dhe 13567/26.08.13, konfirmohet pronësia e subjektit “Fam Gas” sh.p.k dhe që të njëjtat janë shkarkuar dhe janë bartur si marrës në deklaratat IM4 R14464/09.09.13 dhe R-14451/09.09.13, te subjekti “Mazrek Komerc”, e ku veprimi i fundit vërtetohet edhe përmes rubrikës nr. 40 të deklaratave unike doganore IM4 14464/09.09.13 dhe 14451/09.09.13, e që i referohet lidhjes me dokumentin paraprak deklaratat shkarkuese nga IM7. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, Gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuara dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm faktikisht dhe juridikisht për njohjen e TVSH-së së zbritëshme sipas DUD-ve 14464/09.09.2013 dhe 14451/09.09.2013. Prandaj, Gjykata duke vepruar në përputhje

me dispozitat e nenit 81 I, par 2, nënpar 2.2 të ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i njoh si TVSH-së të zbritëshme sipas DUD-ve 14464/09.09.2013 dhe 14451/09.09.2013, në periudhën tatimore kontestuese. Ligji nr. 03/L-146, për tatimin mbi Vlerën e Shtuar, në nenin 37, par 2, Thekson qartë se : Për të ushtruar të drejtën e tij për zbritje të TVSh-se së zbritshme, personi i tatueshëm duhet që së paku: nën paragrafi 2.1. “në lidhje me të gjitha zbritjet e referuara në kreun e 13 të mbajë një faturë ose një dokument që shërben si faturë në pajtueshmëri me kreun 15 të këtij Ligji. në lidhje me zbritjet sipas nën-paragrafit 2.2 të nenit 36 të këtij ligji të ketë një dokument importi “Dokumenti Unik Doganor - DUD” në të cilin ai është i cekur si pranues i dërgesës apo importues dhe i cili e cek shumën ose mundëson llogaritjet e obligimit tatimor”, dhe neni 38, i këtij ligji, e që i referohet mënyrës së ushtrimit të së drejtës për të zbritur TVSH-në e zbritshme, ku në paragrafin 1. Shprehimisht është përcaktuar se “Personat e tatueshëm bëjnë zbritjen duke zbritur nga shuma totale e obligimit të TVSH-së për një periudhë të caktuar tatimore, shumën totale të TVSH-së në lidhje me të cilën gjatë së njëjtës periudhë ka lindur e drejta për ta zbritur në pajtueshmëri me paragrafin 1 te nenit 37 të këtij Ligji”. Pra kusht esencial sipas kësaj dispozite është ekzistimi i një dokument importi “Dokumenti Unik Doganor - DUD” në të cilin ai është i cekur si pranues i dërgesës apo importues dhe i cili e cek shumën ose mundëson llogaritjet e obligimit tatimor, fakt ky i dëshmuar nga paditësi me deklaratat unike doganore IM7 DUD-at 13621/26.08.13, 13562/26.08.13, 13563/26.08.13, 13561/26.08.13, 13338/21.08.13, 13620/26.08.13, 13618/26.08.13, 13616/26.08.13, 13614/26.08.13, 13615/26.08.13, 13613/26.08.13 dhe 13567/26.08.13, në emër të këtu paditësit, e të shkarkuar me deklaratat unike doganore kontestuese IM4 R-14464/09.09.13 dhe R-14451/09.09.13, në emër të “Mazreku Commerce”, por të bartur me dokument noterial dhe të ndërlidhur me deklaratat IM7 përmes rubrikës nr. 40, të DUD-ve kontestues, për qëllime vetëm të zhdoganimit. E paditura më asnjë provë, fakt apo rrethanë nuk e ka bërë të njohur se dokumentacioni i prezantuar nga paditësi nuk është i pranueshëm, apo se është jo valid, pra nuk e ka kontestuar dokumentacionin e prezantuar nga këtu paditësi dhe atë deklarata unike doganore si më lartë dhe marrëveshjet e noterizuara të datës 21.10.2013.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 41 të LKA, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e anuluar vendimin nr.552/18 të datës 08.01.2018 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Pretendimet ankimore të paditurës nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore

siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Pretendimin e të paditurës në ankesë se gjykata është dashur ta ketë parasysh se në këtë konflikt administrativ nuk kanë qenë objekt marrëdhëniet juridiko civile por trajtimi i pretendimeve sipas legjislacionit tatimor i cili parasheh dispozita imperative për çështje tatimore. Kolegji i kësaj gjykate sqaron për të paditurën se pikërisht në vendimin e kundërshtuar në padi ka qenë kontestuese çështja e pronësisë së Deklaratave Unike Doganore, për të cilat paditësit i është refuzuar ankesa dhe është obliguar me detyrime doganore shtesë, prandaj edhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka shqyrtuar dhe sqaruar çështjen e pronësisë së këtyre DUD-ave. Tutje e paditura ka theksuar se Gjykata përmes nxjerrjes së këtij aktgjykimi ka krijuar një precedent shumë të dëmshëm lidhur me trajtimin e TVSH-së s zbritshme përmes DUD-ave doganor të huaj në bazë të marrëveshjeve, të cilat në të ardhmen mund të krijojnë një numër të madh të rasteve përmes të cilave shumë tatimpagues mund të shfrytëzojnë TVSH-në e zbritshme pa qenë e tyre dhe kjo ndikon direkt në buxhetin e Republikës së Kosovës. Edhe këtë pretendim të të paditurës kolegji i kësaj gjykate e konsideron si të pabazuar, për faktin se e drejta për ta zbritur TVSH-në e zbritshme është e drejtë të cilën subjektet e kanë të fituar me ligj, dhe çështja nëse TVSH e zbritshme pranohet për njërin biznes apo tjetrin, varësisht se cili prej tyre i ka në pronësi DUD-at doganor, nuk nënkupton dëmtim të buxhetit të shtetit. Në rastin konkret dëmtimi i është shkaktuar bizneseve kur e paditura, ashtu siç e ka vërtetuar edhe eksperti financiar në ekspertizën e datës 01.07.2021, për subjektin Mazrek Comerc e ka zbatuar marrëveshjen duke mos aplikuar dy herë blerje, ndërsa te subjekti Fam Gas LLC nuk e ka marr për bazë marrëveshjen e noterizuar dhe nuk ka bërë zbatim të kreditimit. Me këto veprime e paditura e ka pamundësuar zbritjen e TVSH-së së zbritshme, si e drejtë ligjore e subjekteve, duke mos e pranuar të njëjtën te asnjëri prej subjekteve. Prandaj pretendimi se gjykata ka krijuar precedent shumë të dëmshëm është i pabazuar dhe i paargumentuar nga ana e të paditurës.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, për arsye se e paditura nuk ka ofruar prova të bazuara që do të ndryshonin gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të palës së paditur.

Mbi këtë gjendje të fakteve Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-102, dhe të LKA-së, dhe nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të palës së paditur, pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.507/22, me datë 22.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova